



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 720/8 Prot.

Tiranë, më 26.04.2021

VENDIM

Nr. 20, datë 26.04.2021

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së, për vitin akademik 2021-2022”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2/b; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1/dh; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31/f; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me shkresën nr. 264/4 Prot., datë 23.03.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 26.04.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2021-2022, në:
 - “Bachelor” në “Bioteknologji”;
 - “Bachelor” në “Kimi Industriale dhe Mjedisore”;
 - “Bachelor” në “Matematikë”;
 - “Master i Shkencave” në “Bioteknologji”;
 - “Master i Shkencave” në “Mësues Kimie për Arsimin e Mesëm të Lartë”;
 - “Master i Shkencave” në “Mësues Matematike për Arsimin e Mesëm të Lartë”;
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

